- (a) Nëse ka një mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit për njësi me sasinë, çmimi për njësi do të mbizotërojë dhe çmimi total do të ndryshohet përkatësisht.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje në çmimin total, kur totali është shuma ose diferenca e nën-totaleve, çmimi nën-total mbizotëron dhe çmimi total korigjohet bazuar në të.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis fjalëve dhe numrave, shuma me fjalë do të mbizotërojë. Përrjashtim nga ky rregull është situata kur shuma ka të bëjë me gabimin, i cili do të korigjohet sipas pikave (a) dhe (b) më lart, prandaj në këtë rast shuma në numër mbizotëron dhe ajo me fjalë do të korigjohet.
- (d) Nëse ekziston një mospërputhje midis fjalëve dhe shifrave, shuma me fjalë do të mbizotërojë, përveç nëse shuma e shprehur me fjalë lidhet me një gabim aritmetik, rast në të cilin shuma në shifra do të mbizotërojë në bazë të (a) dhe (b) më sipër.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- vlera absolute e të gjitha korigjimeve është më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- vlera absolute e të gjitha korigjimeve është më pak se 2%, por korigjimi nuk pranohet nga ofertuesi.

2. Kur autoritetet kontraktore vërejnë se oferta është anomalisht e ulët, i kërkojnë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin dhe në përputhje me dispozitat e këtij neni.

- Në rast kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët kur zvogëlohet më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.
- Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më pak se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, para se të marrë një vendim për kualifikimin e tyre ose jo, në përputhje me nenin 93 të LPP-së.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin / elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

**O - Oferta**

**MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme**

**N - Numri i ofertave të vlefshme**

**PR (Zm) – Zbritje e mundshme**

**MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N**

**PR = 85 % Mo**

**Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR ..... rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët**

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

## **D. DHËNIA E KONTRATËS**

**23. Njoftimi i Fituesit** 1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

**24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës** 1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

a) garanci bankare

- 
- b) garanci nga shoqëri sigurimi.

#### **DH. ANKESAT**

##### **25. Procedura e ankesës**

1. Cdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
2. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

#### **E. ANULIMI I PROCEDURËS**

##### **26. Anulimi i procedurës**

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
  - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
  - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
  - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
  - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
  - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

- Shtojca 1. Formulari i Ofertës .....
- Shtojca 2. Lista e Çmimeve të Sherbimeve .....
- Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës .....
- Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial.....
- Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike .....
- Shtojca 6. Formulari i shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit .....
- Shtojca 7. Termat e referencës
- Shtojca 8. Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve .....
- Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....
- Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit .....
- Shtojca 11 - Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak) .....
- Formulari 12 Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)
- Shtojca 13 : Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)
- Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

---

## Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Shërbimeve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
  - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  - 2. Njoftimin e Kontrates;
  - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
  - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
  - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
  - 7. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**



---

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë _____</b>	

**Shtojca 2.***(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**  
\_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Shërbimet në Formularin e grafikut të realizimit për Shërbimet duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për Shërbim. Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Shërbimi	Përshkrimi i shërbimi	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim(3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total (Shërbimet)</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					
<b>Nënshkrimi</b>					

---

<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

---

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

---

#### **Shtojca 4.**

*(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

#### **Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### **VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Përfaqësuesi i Ofertuesit**

#### **Nënshkrimi**

#### **Vula**

---

## Shtojca 5.

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

---

## Shtojca 6

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

### FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

#### Shërbimet që kërkohen që kërkohen:

**Loti i I:**(Mbikqyrja e punimeve per objektin, “**Ndërtim ure BOX B/A (5X2m), rruga e fshatit Zallë, bashkia) Krujë**”).

**Loti i II:**(“Mbikqyrja e punimeve për objektin, “**Punime për rehabilitimin e shkarkuesit të rezervuarit Verjon dhe sistemim përroi Lagja N.3 Kovaçe, Krujë ‘**”).

#### Afatet e ekzekutimit:

**Loti i I:**(Mbikqyrja e punimeve per objektin, “**Ndërtim ure BOX B/A (5X2m), rruga e fshatit Zallë, bashkia) Krujë**”, nga data e lidhjes se kontrates deri ne perfundim te afatit te zbatimit te punimeve [afati **60** (gjashtedhjete) dite].

**Loti i II:**(“Mbikqyrja e punimeve për objektin, “**Punime për rehabilitimin e shkarkuesit të rezervuarit Verjon dhe sistemim përroi Lagja N.3 Kovaçe, Krujë ‘**”), nga data e lidhjes se kontrates deri ne perfundim te afatit te zbatimit te punimeve [afati **7** (shtate) muaj].

---

## Shtojca 7

( Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

### TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Detyrat:

Shpërndarja:

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve:

### TERMAT E REFERENCËS

“ **MBIKQYRJA E PUNIMEVE PER OBJEKTET NDERTIMORE TE BASHKISE KRUJE (FAZA E IV-te )**”.

- **Loti i I:** (Mbikqyrja e punimeve per objektin: “Ndërtim ure BOX B/A (5X2m), rruga e fshatit Zallë, bashkia) Krujë”
- **Loti i II:** (“Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Punime për rehabilitimin e shkarkuesit të rezervuarit Verjon dhe sistemin përroi Lagja N.3 Kovaçe, Krujë”.

#### 1. Objektivi kryesor i Mbikqyresit

1.1-Mbikqyresi i punimeve te zbatimit te objektit ka per qellim te kontrolloje dhe te ndjeke mbarevajtjen e gjithe procesit te zbatimit te punimeve ne perputhje me projektin, kushtet teknike te zbatimit, specifikimet teknike, si dhe destinacionin e objektit, duke patur parasysh afatin kohor te percaktuar per kryerjen e punimeve ne perputhje te plote me rregullat e modalitetet e **VKM nr.610 date 22.09.2022** 'Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”.

#### 2. Detyrat, pergjegjesite dhe te drejtat e Mbikqyresit

2.1 Ne realizimin e objektivave per zbatimin e punimeve te projektit, Mbikqyresi menjehere mbas lidhjes se kontrates duhet:

- Te mbikqyre kontraten e zbatimit te punimeve ne emer te Autoritetit Kontraktor dhe te kryeje te gjitha detyrimet sipas kontrates se nenshkruar dhe legjislacionit ne fuqi.



---

- Te njihet ne detaj me projekt-zbatimin dhe specifikimet teknike te objektit, te hartoje programin e kontrollit per zbatimin e projektit dhe cilesise se punimeve, si dhe zbatimit te VNM ne baze te standarteve te percaktuara me ligj (sipas Ligjit Nr. 8402, dt. 10.09.1998 dhe **VKM nr.610 date 22.09.2022**“Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësive profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”).

- Te paraqese prane Autoritetit Kontraktor stafin e tij mbikqyres, siç eshte percaktuar ne kerkesat e stafit kryesor.

- Ne baze te volumit te punimeve dhe vleres se kontrates Mbikqyresi i punimeve duhet te jete rezident me kohe pune te plote ne objekt, ndersa stafi tjeter mbikqyres mund te jete rezident ne objekt me kohe te pjesshme.

2.2 Mbikqyresi i punimeve dhe stafi i tij kontraktohet nga Autoriteti Kontraktor, duke percaktuar detyrimet e ndersjellta, kushtet e punes, shperblimin, etj.

2.3 Mbikqyresi ve ne dijeni Autoritetin Kontraktor per nenkontraktoret e mundshem qe zgjedh Sipermaresi (Zbatuesi i Punimeve) ne perputhje me kontraten e zbatimit te punimeve.

2.4 Mbikqyresi ne fillim te punimeve ne objekt, merr kontakt me organet qeverisese, ne juridiksionin e te cilit ndodhet zona ku kryhet ky objekt, dhe informon personat kryesore pergjegjes per ndertimin e ketij objekti, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi (Neni 9, ligji Nr.8402, dt.10.09.1998 dhe **VKM nr.610 date 22.09.2022**).

### 3. Detyrat e mbikqyresit

#### 3.1 Mbikqyresi ka per detyre:

- Te ndjeki me rigorozitet dhe te ushtroje detyren e tij ne perputhje me te gjitha detyrimet qe rrjedhin nga **VKM nr.610 date 22.09.2022**“Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësive profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”

- Te kontrolloje vendosjen e tabelës së identifikimit të objektit me të dhënat e mëposhtme:

- Emertimi i objektit:
- Investitori:
- Sipermarresi dhe drejtuesi teknik:
- Mbikqyresi:
- Afati i ndertimit te objektit:
- Vlera e objektit:

#### 3.2 Mbikqyresi menjehere mbas lidhjes se kontrates duhet :

- Te marre masat e duhura per sigurine e objektit duke kontrolluar vendosjen ne objekt te tabelave perkatese sinjalizuese, treguese e te sigurise, shiritave, fenereve, etj.

---

- Mbas verifikimit të dokumentacionit duhet të dorëzohet pranë Autoritetit Kontraktor të gjithë dokumentacionin, si dhe shkresën për fillimin e punimeve ku të përfshihen:

- Staf i Sipermarresit
- Makineritë që do përdoren.

- Para fillimit të punimeve verifikon të gjitha pajisjet dhe makineritë e Sipermarresit, për të parë nëse ato i përgjigjen kushteve të kontratës së zbatimit.

- Të kontrollojë zbatimin e projektit duke u bazuar në projekt zbatimin dhe specifikimet teknike dhe të propozojë modifikimet, plotësimet dhe mospërputhjet, nëse ka, dhe të propozojë Autoritetit Kontraktor zgjidhjet konkrete.

- Të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme e të kualifikuar të gjitha proceset e punimeve dhe dokumentacioneve që duhen të mbahen gjatë zbatimit të punimeve.

- Të kontrollojë në mënyrë korrekte dhe të vazhdueshme pëktimin e objektit dhe çdo material që vendoset në veprë, mënyrën e vendosjes së tij dhe cilësinë e tij.

- Për çdo punim të maskuar të bëjë (fotografimin ose regjistrimin e tij dhe të mbajë procesverbal të firmosur prej tij dhe sipermarresit.

- Të kontrollojë çertifikatat e cilësisë së materialeve dhe të japë miratimin për vendosjen e tyre në objekt.

- Korrespondenca ndërmjet palëve bëhet gjithnjë në mënyrë zyrtare, me shkrim.

#### **4. Përgjegjësi e Mbikqyresit**

4.1 Në fillim të punimeve Mbikqyresi mban dhe ka përgjegjësi për dokumentacionin e mëposhtëm:

- Projektin e firmosur nga investitori me specifikimet teknike.
- Dokumentacionin për realizimin e punimeve të objektit sipas projektit, kushteve teknike të zbatimit në fuqi dhe specifikimeve teknike.
- Saktësinë e vërtetësinë e dokumenteve, volumet dhe cilësinë e punimeve.
- Për realizimin me korrektesë të kontratës së nënshkruar midis Sipermarresit dhe Autoritetit Kontraktor, për realizimin e të gjithë fazave të zbatimit të punimeve, respektimit të afatit të dorëzimit.
- Asnjë punim nuk do të mbulohet, maskohet apo betonohet pa miratimin e Mbikqyresit. Sipermarresi duhet të njoftojë Mbikqyresin kur është gati për t'u ekzaminuar prej tij.

#### **5. Të drejtat e Mbikqyresit**

5.1 Mbikqyresi ka të drejtë:

- Të mos pranojë drejtues teknik, manovrator, punëtor, etj, nëse këta nuk plotësojnë kushtet për të kryer detyrën e caktuar.

- Te pezulloje punimet kur sheh se ne objekt nuk jane marre masat e duhura per te siguruar punimet dhe trafikun.
- Te mos lejoje vendosjen ne veper te materialeve qe nuk plotesojne kushtet e cilesise.
- Te kerkoje per te gjitha makinerite qe punojne ne veper dokumentacionet teknike per te siguruar nje ecuri punimesh te sigurta dhe cilesore.
- Per çdo ndryshim te mundshem ne objekt, Mbikqyresi i punimeve ve ne dijeni Autoritetin Kontraktor.

## 5.2 Ky dokumentacion duhet te permbaje:

- Proçes-verbalin per fillimin e punimeve
- Projekt organizimin e punimeve
- Projektin teknik te zbatimit
- Grafikon e punimeve
- Specifikimet teknike
- Dokumentacionin fotografik apo video regjistruesi per punimet e padukshme
- Proçes-verbalet e çdo punimi te maskuar te firmosur nga drejtuesi teknik dhe Mbikqyresi te shoqeruar me fotografi
- Çertifikatat e cilesise se materialeve
- Deklaraten teknike te Sipermarresit te firmosur nga Sipermarresi dhe drejtuesi teknik
- Njoftimin e sipermarresit per perfundimin e punimeve
- Proçes-verbalin e perfundimit te punimeve te firmosur nga Sipermarresi dhe Mbikqyresi.
- Relacionin perfundimtar te Mbikqyresit

5.3-Nje kopje e te gjithë dokumentacionit dorezohet sipas kerkesave te **VKM nr.610 date 22.09.2022** ‘‘Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve’’

## 6. Kohezgjatja e sherbimit te Mbikqyrjes:

Afati i realizimit të supervizionit të punimeve do të jetë i njëjtë me afatin e realizimit të punimeve nga sipermarresi i cili do të zbatojë punimet si dhe inspektimet gjatë periudhës së garancisë kur kërkohet nga investitori.

**Shenim:**Per cdo gje qe nuk eshte parashikuar ne keto terma , Mbikqyresit dhe Autoriteti Kontraktor duhet ti referohen **VKM nr.610 date 22.09.2022**‘‘Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve’’.

**Shenim:**Termet e references se sherbimit jane ekuivalente per te dy lotet respektive.

---

## Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

---

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

**Shenim-Kriteret dhe kushtet e përgjithshme janë ekuivalente për te 2 (dy) lotet respektive**

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **LOTI I: (MBIKQYRJA E PUNIMEVE PËR OBJEKTIN, “NDËRTIM URE BOX B/A (5X2M), RRUGA E FSHATIT ZALLË, BASHKIA) KRUIJË”)**

#### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; (Ne vleren prej 2% të fondit limit të lotit respektiv)*

#### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**1-a)** Operatori ekonomik nuk duhet të ketë detyrime të taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe ato të vitit 2023 të njohura nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka selinë në rast se janë plotësuar afatet e maturimit të detyrimeve vendore për periudhën e mesipërme në përputhje me kërkesat e ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. *(Edhe në rastet e bashkimit të operatorëve duhet të ketë vërtetimin e shlyerjes së taksës vendore 2023 për secilin operator)*

**Shenim-**Për të përmbushur këto kritere në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.9, ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje me nenin 26.6 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, duhet të dorëzojë dokumentacionin provues si më poshtë :

- Vertetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe detyrimet vendore për vitin 2023 të lëshuar nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka selinë sipas QKB, në rast se janë plotësuar afatet e maturimit të detyrimeve vendore për periudhën e mesipërme në përputhje me kërkesat e ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. (Edhe në rastet e bashkimit të operatoreve duhet të ketë vertetimin e shlyerjes së taksës vendore 2023 për secilin operator).

## 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

a)-Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 ).

b) Ofertuesi duhet të jetë i pajisur me licencë të vlefshme profesionale të shoqërisë dhe të drejtuesve teknikë, për Mbikqyrje dhe Kolaudim të Punimeve të Zbatimit , të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore (sipas modelit të miratuar nga MZHU/MTI/MIE) me kategoritë e mëposhtme:

- **NP-1** Punime gërmimi në tokë.
- **NP-4** Rrugë, autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.
- **NS-18** Punime topogjeodezike.

**Shenim** –Licenca duhet të jete lëshuar sipas rregullave të VKM nr.759 datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” (Ndryshuar me VKM nr.943, datë 28.12.2016)

- *Shoqëritë e huaja, në lidhje me ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës, të zbatojnë legjislacionin shqiptar në fuqi*

## 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.a-Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in kopje të deklarimit të xhiros vjetore për 3(tre) vitet financiare (2020’2021’2022 ) , ose vertetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës e fondit limit të **kontrates/ lotit nr.1(për secilin prej loteve/ shumatores së loteve për të cilat konkurron)**.

**Shenim**-Pika 2.2-a) plotësohet duke paraqitur vertetimin përkatës të Administratës Tatimore .

## 2.3 Kapaciteti teknik:

### 2.3.1-Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a)Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës **me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës** së përllëgaritur të kontratës/lotit **(për secilin prej loteve / shumatores së loteve për të cilat konkurron)**, që prokurohet .

**Për të vërtetuar këtë Operatorët Ekonomik duhet të paraqesin:**

- Kur furnizimi i shërbimeve të mëparshme të ngjashme, është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur vertetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kontratës si dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të

---

legjislaconit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, të nënshkruara nga të dyja palët.

- Kur shërbimet e mëparshme të ngjashme është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë furnizim duke paraqitur vetëm faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislaconit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, të nënshkruar nga të dyja palët.

**2.4-a)** Operatorët ekonomik në përgatitjen e ofertës së tyre ekonomike/financiare duhet të referohen VKM nr.354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim", si dhe Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik datë 25.07.2017, me Nr. 5585 Prot "Mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354, datë 11.05.2016" "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim" si dhe Rekomandimit të datës 27.06.2018 me nr 6559 prot të APP.

- **b) Shenim**-Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet të jete brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM nr 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim".
- Fondi limit i preventivit të zbatimit të objektit, "**Ndërtim ure BOX B/A (5X2m), rruga e fshatit Zallë, Bashkia Krujë**", është **2'608'644 (dymilion e gjashtëqind e tetemije e gjashtëqind e dyzet e kater) lekë pa t.v.sh**
- Reference për perlllogaritjen e tarifës (fondit limit) për vlerën e mbikqyrjes /kolaudim është përdorur **Grupi Tarifor III sipas** tabelës përkatëse V.K.M nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim".

-

**Shenim:** Në zbatim të nenit 82.5 të Ligjit nr 162/2020 "Për Prokurimin Publik" dhe të pikës 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: "Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike<sup>2</sup>. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislaconi në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

---

<sup>2</sup> Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

- 
- Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit të operatorit fitues para lidhjes së kontratës, në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kushtin s'kualifikimi.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**LOTI I II: ("MBIKQYRJA E PUNIMEVE PËR OBJEKTIN, "PUNIME PËR REHABILITIMIN E SHKARKUESIT TË REZERVUARIT VERJON DHE SISTEMIM PËRROI LAGJA N.3 KOVAÇE, KRUIJË").**

### **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

#### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; (Në vlerën prej 2% të fondit limit të lotit respektiv)

#### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**1-a)** Operatori ekonomik nuk duhet të ketë detyrime të taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe ato të vitit 2023 të njohura nga ana e njësive vendore ku operatori ekonomik ka selinë në rast se janë plotësuar afatet e maturimit të detyrimeve vendore për periudhën e mesipërme në përputhje me kërkesat e ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. (Edhe në rastet e bashkimit të operatoreve duhet të ketë vertetimin e shlyerjes së taksës vendore 2023 për secilin operator)

**Shenim-** Për të përmbushur këto kriter në fazën e ofertimit është e nevojshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.9, ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje me nenin 26.6 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, duhet të dorëzojë dokumentacionin provues si më poshtë:

- Vertetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe detyrimet vendore për vitin 2023 të leshuar nga ana e njësive vendore ku operatori ekonomik ka selinë sipas QKB, në rast se janë plotësuar afatet e maturimit të detyrimeve vendore për periudhën e mesipërme në përputhje me kërkesat e ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. (Edhe në rastet e bashkimit të operatoreve duhet të ketë vertetimin e shlyerjes së taksës vendore 2023 për secilin operator).

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

a)-Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9).



b) Ofertuesi duhet të jetë i pajisur me licencë të vlefshme profesionale të shoqërisë dhe të drejtuesve teknikë, për Mbikqyrje dhe Kolaudim të Punimeve të Zbatimit, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore (sipas modelit të miratuar nga MZHU/MTI/MIE) me kategoritë e mëposhtme:

- **NP-1** Punime gërmimi në tokë.
- **NP-9** Punime mbrojtje lumore, sistemime hidraulike, bonifikime.
- **NS-18** Punime topogjeodezike.

**Shenim** –Licensa duhet të jete lëshuar sipas rregullave të VKM nr.759 date 12.11.2014 “Per licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” (Ndryshuar me VKM nr.943, datë 28.12.2016)

- *Shoqëritë e huaja, në lidhje me ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës, të zbatojnë legjislacionin shqiptar në fuqi*

## 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.a-Operatori/et Ekonomik** duhet të paraqes/in kopje të deklaramit të xhiros vjetore për 3(tre) vitet financiare (2020’2021’2022), ose vertetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës e fondit limit të kontratës/ **lotit nr.2(për secilin prej loteve/ shumatores së loteve për të cilat konkurron)**.

**Shenim-Pika 2.2-a)** plotësohet duke paraqitur vertetimin përkatës të Administratës Tatimore.

## 2.3 Kapaciteti teknik:

### 2.3.1-Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a)Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës **me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës/lotit (për secilin prej loteve / shumatores së loteve për të cilat konkurron)**, që prokurohet.

**Për të vërtetuar këtë Operatorët Ekonomik duhet të paraqesin:**

- Kur furnizimi i shërbimeve të mëparshme të ngjashme, është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kontratës si dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, të nënshkruara nga të dyja palët.
- Kur shërbimet e mëparshme të ngjashme është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë furnizim duke paraqitur vetëm faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, të nënshkruar nga të dyja palët.

**2.4-a)**Operatorët ekonomik në përgatitjen e ofertes së tyre ekonomike/financiare duhet të referohen VKM nr.354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, si dhe Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik datë 25.07.2017, me Nr. 5585 Prot “Mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuar në Vendimin e

---

*Këshillit të Ministrave Nr.354, datë 11.05.2016” “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim” si dhe Rekomandimit të datës 27.06.2018 me nr 6559 prot të APP.*

